

**Rregulla XXIX mbi Pagesën Direkte dhe Indirekte të Kredive në Para të Gatshme  
E autorizuar sipas Nenit 46 të Rregullores së UNMIK-ut 1999/21 dhe  
Nenit 42(a) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/47**

## **1. Përmbledhje**

Kjo Rregull adreson praktikën e dhënies së mjeteve të kredisë huamarrësve, qoftë në formë të parave të gatshme qoftë duke lejuar tërheqjen e mjeteve të kredisë në para të gatshme nga llogaritë e klientëve. Këto praktika po konsiderohen si jo të sigurta dhe jo të shëndosha, kështu që paraqesin dobësi serioze në sistemet e kontrollit të brendshëm dhe të menaxhimit të rrezikut kreditor. Për më tepër, praktikat e tilla e mundësojnë pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit.

## **2. Fushëveprimi**

Kjo Rregull zbatohet për të gjitha institucionet kredidhënëse në Kosovë.

## **3. Definicionet**

Vlejnë definicionet e paraqitura në Rregulloren e UNMIK-ut 1999/21.

## **4. Kërkesat**

a. Pagesa e kredive me para të gatshme apo tërheqja e mjeteve së kredisë në para të gatshme në shumë më të lartë se 10,000 € (dhjetëmijë Euro) është e ndaluar përveç nëse është e mbështetur me të dhëna valide të dokumentuara për përdorimin e mjeteve të tilla. Bankat janë përgjegjëse për të ushtruar kujdesin e duhur në përcaktimin e vërtetësisë së dokumentacionit mbështetës.

b. Fondet e kredive në shumë prej 50,000 Euro apo më shumë, mund të paguhen vetëm me anë të transfereve nga institucioni kredidhënës në llogarinë(të) e ligjshme të furnizuesit të huamarrësit(ve) me të mira materiale dhe shërbime.

c. Institucionet kredidhënëse nuk do të strukturojnë transaksionet në mënyrë që t'i shmangen kërkesave të nënparagrafeve a. dhe b.

d. Institucionet kredidhënëse për të qenë në pajtim me nënparagrafin a., mund të themelojnë sistemet e brendshme që do të shërbenin si mbështetje e dokumentuar për përdorimin e mjeteve kreditore.

## **5. Data e hyrjes në fuqi**

Këshilli Drejtues i Autoritetit Qendror Bankar të Kosovës ka miratuar këtë Rregull XXIX më 31 tetor 2007. Rregulla hyn në fuqi më 1 janar 2008.

Michel Svetchine  
Drejtor i Përgjithshëm